



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT

KORÇË

VENDIM

Nr 16 Datë 26.11.2007

PËR

MIRATIM FONDI PËR BLERJE PAJISJE PËR POLICINË
BASHKIAKE

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, mbasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Punëve Publike «PËR MIRATIM FONDI PËR BLERJE PAJISJE PËR POLICINË BASHKIAKE», bazuar në ligjin nr. 8652 dt. 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", neni 32 pika "dh", ligjin nr 8399 dt. 09.09.1998 "Për buxhetin lokal". Ligjin nr 9645 dt. 27.11.2006 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2007". Udhëzimin nr 2 dt. 17.01.2007 të M.F. "Për zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2007". Udhëzimin nr 353 dt.19.03.2007 të Ministrisë së Brendshme "Për zbatimin e Buxhetit të Qeverisjes Vendore për vitin 2007". Ligjin nr 9808 dt. 24.09.2007 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8378 dt.22.07.1998 "Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë". si dhe V.K.B. nr. 2 dt. 02.02.2007 "Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë dhe institucioneve të vartësisë për vitin 2007", mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimit të anëtarëve:

VENDOSI

1. Të miratojë fondin prej 108.000 lekë për blerjen 6 copë bllokues rrotash për Policinë Bashkiake.

2. Ky fond do të përballohet nga fondi i planifikuar i shpenzimeve operative për vitin 2007 duke pakësuar zërin "riparim e pajisje makinash" në vlerën 108.000 lekë me këtë strukturë buxhetore:

Pakësohet 00 01110 05 Art 6020000 - 108 000lekë

Shtohet 00 01110 05 Art 2310000 + 108 000 lekë

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës, Drejtoria e Personelit, Protokoll-Arkivës dhe Mbështetjes, Drejtoria Juridike si dhe Drejtoria Policisë Bashkiake në Bashki.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare e Këshillit

Raimonda NASE
Raimonda NASE